



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Zyra e Kryetarit të Komunës

Nr 01-020/02-32060

Datë 13.07.2026

Në bazë të nenit 7 të Ligjit për Policinë (Ligji nr. 04/ L-076) , nenit 3 ,nenit 4. dhe nenit 9.1.1 të Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 MPB,përkatësisht UA 03/2012 të MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, Kryetari i komunës së Lipjanit i bënë

FTESË PUBLIKE

për propozimin e anëtarit/es në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) nga komuniteti shqiptar

Kryetari i komunës së Lipjanit ,-njëherësh **Kryesues i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi / KKSB/** i fton qytetarët e Komunës së Lipjanit që në përputhje me nenin 4 .1.3 dhe 4.1.4. të Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 të MPB përkatësisht 03/2012 të MAPL të propozojnë një anëtar/e nga komuniteti shqiptar për përfaqësuesim në KKSB të Komunës së Lipjanit.

Anëtari i KKSB-së nga Komuniteti shqiptar ashtu si edhe anëtarët e tjerë të KKSB-së ka mandat të njëjtë me anëtarët e kuvendit komunal dhe zgjedhja e ti në këtë periode bëhet për shkak se anëtari i mëhershëm i KKSB-së nga komuniteti shqipëtar ka ndërruar jetë

Objektivat e KKSB –së janë:

- rritja e vetëdijesimit të qytetarëve lidhur me natyrën e krimeve, parregullsitë dhe sjelljet e dhunshmen komunitetin lokal;
- identifikimi i brengave lidhur me sigurinë publike;
- rekomandimi i planeve te veprimit dhe adresimi i brengave të qytetarëve te autoritetet komunale;

- ndërtimi i besimit në mes të policisë dhe qytetarëve nëpërmjet të ndërtimit të partneritetit dhe iniciativave të përbashkëta për zgjidhjen e problemeve të sigurisë në çdo bashkësi;
- përfaqësimi i pikëpamjeve dhe shqetësimeve të të gjithë qytetarëve për çështjet e krimit dhe për çështjet tjera që lidhen me kualitetin e jetës

Detyrat dhe përgjegjësitë e KKSB-së

- Përgatitja e planit vjetor të punës dhe zhvillimi i projekteve për rritjen dhe përmirësimin e sigurisë në bashkësi;
- Identifikimi i dukurive negative që tentojnë të prishin sigurinë publike dhe rekomandojë planet e veprimit;
- Bashkëpunimi me policinë në parandalimin e veprimeve të cilat e kërcënojnë sigurinë në bashkësi;
- Bashkëpunimi me institucionet qendrore që merren me sigurinë publike, me qëllim të krijimit të një ambienti sa më të sigurt në bashkësi;
- Lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit me KKSB-të e komunave fqinje për çështjet e sigurisë në bashkësi që i tejkalojnë kufijtë e komunës;
- Të kërkojë nga Kuvendi Komunal financimin e projekteve të lidhura me sigurinë në bashkësi;
- Fton në takimet e tyre përfaqësuesit e MPB-së, DSB;
- Fton përfaqësuesit nga institucionet qeveritare, të mediave ose përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile që të marrin pjesë në takimet e KKSB-së;
- Kërkon nga policia përgjigje për rastet që janë me rëndësi për sigurinë në bashkësi duke mos ndërhyrë në procesin e hetimeve policore;
- Mbajtja e takimeve të rregullta (së paku 6 takime në vit).

Luteni që propozimet e komunitetit tuaj ti dërgoni brenda afatit 7 ditë pune nga dita e publikimit të kësaj ftese publike.

Aplikacionet dorëzohen në ndërtesën e Komunës kati përdhësë, sporteli nr.2.në pliko të mbyllur .

Kryesuesi i KKSB-së së Lipjanit
Imri Ahmeti

